

TË DREJTAT E NJERIUT NË MJEDISËT E PRIVIMIT TË LIRISË PËRGJATË PANDEMISË COVID-19

RASTI I SHQIPËRISË



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**TË DREJTAT E NJERIUT NË MJEDISËT E PRIVIMIT TË LIRISË
PËRGJATË PANDEMISË COVID-19
RASTI I SHQIPËRISË**

Tetor 2020

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2020

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose rishtypet, me kusht që të njihet autorësia e tij.

Ky botim u përgatit në kuadër të Projektit të OSBE-së “Promovimi dhe nxitja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri – Faza III”

Bazuar në kontributin e: Znj. Erinda Ndroqi (Bllaca), Konsulente



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Përmbajtja

Akronime dhe shkurtime	Faqe 4
Përmbledhje	Faqe 5
Hyrja dhe konteksti.....	Faqe 6
Metodologjia.....	Faqe 9
Analiza e kuadrit ligjor vendas, kuadrit rregullator dhe kushteve në burgje.....	Faqe 10
Gjetjet kryesore.....	Faqe 11
Rekomandimet dhe mësimet e marra	Faqe 22
Bibliografia.	Faqe 24

Akronime dhe Shkurtime

GDP	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
IEVP	Institucionet për Ekzekutimin e Vendimeve Penale
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KNDKP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
KPT	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtërues
MKPT	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
MPKI	Masat për Parandalimin dhe Kontrollimin e Infeksionit
NPT	Nënkomiteti i OKB-së për Parandalimin e Torturës
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

Përmbledhje

Viti 2020 e gjeti të tërë botën duke u përballur me shpërthimin e koronavirusit (COVID-19). Kriza e COVID-19-ës pati pasoja për ekonominë botërore, shëndetin publik dhe mënyrën e jetesës. Virusi solli një regjim të ri të distancimit social dhe fizik, infektoi 33,777,641 milion persona në të gjithë botën, i mori jetën më shumë se 1,009,097 personave dhe i bëri qeveritë të merrnin masa drastike karantinimi dhe mbylljeje për të kufizuar përhapjen e COVID-19-ës.¹

Masat e izolimit, kufizimit të lëvizjeve, karantinimit dhe të mbylljes kanë patur ndikim të gjerë të mënyra e jetesës, përqasja dhe sjellja e njerëzve. Lidhja ndërmjet pandemisë COVID-19 dhe heqjes së lirisë u ka dhënë hov shumë diskutimeve, rreziqeve dhe vështirësive. Çfarë ndikimi ka pasur kjo krizë tek zbatimi i të drejtave themelore dhe çfarë ndryshimesh u ka shkaktuar jetëve të personave të privuar nga liria? Këto janë pyetjet që udhëhoqën këtë studim, duke analizuar kontekstin e Shqipërisë dhe përgjigjet institucionale për trajtimin e krizës së shkaktuar nga pandemia.

Sistemi shqiptar i burgjeve reagoi duke zbatuar disa akte rregullatorë, urdhra, udhëzime dhe plane veprimi që e vendosnin përparësinë tek masat parandaluese dhe izoluese. Me qëllim uljen e mbipopullimit në burgje, Ministria e Drejtësisë miratoi një akt normativ për lirimin tre-mujor me kusht të 392 individëve të burgosur, të cilët përbënin rrezik të ulët për shoqërinë, duke përfshirë të dënuar në moshë të vjetër, të burgosur jo të dhunshëm dhe me rrezik të ulët dhe ata me sëmundje të renda mjekësore². Mbyllja në burgje ndikoi te puna e këshilluesëve ligjorë, vizitat e të cilëve në burgje u pezulluan *de facto*. Edhe vizitat e familjarëve dhe veprimtaritë jashtë qelive u pezulluan. E njëjta gjë ndodhi me mekanizmat e mbikëqyrjes së mjedisëve të privimit të lirisë, duke çuar në vështirësi për të reaguar ndaj ankesave të të burgosurve. Në këto kushte, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve e rishikoi vendimin për ndalimin e përdorimit të internetit dhe telekomunikimit në regjimin e burgjeve, duke lejuar përdorimin e telefonatave me video dhe organizimin e takimeve me anë të internetit si zëvendësues të takimeve fizike.

1 Të dhënat u referohen përditësimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë në lidhje me koronavirusin (të datës 30 shtator 2020), [website]: <https://covid19.who.int/>

² Akti Normativ Nr. 7/2020 “Për dhënien e lejes së përkohshme për të burgosurit e dënuar, të cilët lejohen të qëndrojnë në shtëpi për një periudhë tre mujore”.

Ndikimi që pati mbyllja e plotë të drejtat themelore u shfaq kryesisht në fushën e mbrojtjes së shëndetit të të privuarve nga liria dhe veçanërisht tek parimi i barazvlefshmërisë së kujdesit shëndetësor dhe të qasjes në kujdesin shëndetësor³. Mbyllja ishte pozitive, pasi arriti ta mbante të izoluar epideminë në disa burgje. Sipas DPB-së, ka pasur 71 të burgosur të infektuar nga 289 të testuar, dhe 76 anëtarë të personelit të infektuar nga 423 të testuar.⁴

Në bazë të gjetjeve të mësipërme, raporti jep rekomandime për ndërhyrje afatshkurtra dhe afatmesme në lidhje me trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve në përputhje me parimet dhe standardet e pranura ndërkombëtarisht. Ai gjithashtu thekson të drejtën për informim të shpejtë dhe të përditësuar në lidhje me epideminë, apo me izolimin mjekësor, me qëllim uljen e pasigurisë dhe garantimin e kujdesit të shëndetit mendor për të burgosurit në një hark kohor afatgjatë. Dhe në fund, raporti ofron rekomandime në lidhje me mundësinë e njëvale epidemike të re, mbi garantimin e rritjes së vigjilencës për personelin e burgjeve, qasjen e duhur në kujdesin shëndetësor, qasjen në këshillimin ligjor (veçanërisht për të paraburgosurit) dhe qasjen në informacione të shpejta dhe të përditësuar. Raporti mund të krijojë bazën për tendencat e dokumentimit në muajt e ardhshëm dhe të mundësojë trajnim dhe rritje të kapaciteteve për menaxhimin e efektshëm.

Hyrja dhe konteksti

Personat e privuar nga liria, si për shembull të burgosurit dhe personat që ndodhen në mjedise të tjera të privimit të lirisë, shihen si më të cënueshëm nga COVID-19a krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë, për arsye të kushteve të kufizuara ku ata jetojnë së bashku për periudha të zgjatura kohore. Gjithashtu, përvoja tregon se mjediset e privimit të lirisë (d.m.th. burgjet dhe mjediset e paraburgimit) ku njerëzit grumbullohen në afërsi të njëri tjetrit, mund të kthehen në burim infeksioni dhe mund t'i amplifikojnë dhe t'i përhapin sëmundjet infektive si brenda dhe jashtë atyre mjediseve.

³ E njëjta, paragrafi 6.

⁴ Te dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Të dhënat deri më datën 30 shtator 2020.

Të burgosurit janë të cënueshëm për një sërë arsyes, veçanërisht për shkak të afërsisë në të cilën jetojnë (ose punojnë) me të tjerë, në shumë raste në kushte të mbingarkuara, të kufizuara dhe me pak qarkullim ajri. Ata gjithashtu kanë karakteristika të përbashkëta demografike, përgjithësisht me shëndet më të dobët krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë dhe shpesh me sëmundje të tjera ekzistuese. Standardet e higjienës janë shpesh nën ata të komunitetit dhe ndonjëherë faktorët e sigurisë, apo të infrastrukturës, i zvogëlojnë mundësitë për të larë duart, apo për të përdorur dezinfektues duarsh. Në parim, shpërthimi i koronavirusit në burgje nuk duhet t'i kapë në befasi drejtuesit e burgut, pasi ata duhet të kenë plane emergjence për menaxhimin e shpërthimeve të sëmundjeve ngjitëse. Kjo është pjesë thelbësore e detyrimit që ka shteti për të garantuar kujdesin shëndetësor të njerëzve nëpër burgje, sikurse kërkohet nga legjislacioni ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Shqipëria ka 24 institucione burgimi, 17 prej të cilave janë të sigurisë së lartë dhe të mesme, me seksione të posaçme paraburgimi (Tiranë, Fushë-Krujë, Rrogozhinë, Peqin, Shkodër, Lezhë, Korçë); qendra paraburgimi (Tiranë, Elbasan, Lushnjë, Berat, Vlorë); 1 institucion të posaçëm për personat që marrin trajtim të detyruar dhe për të dënuarit me moshë mbi 65 vjeç (Krujë); 1 qendër për rehabilitimin e të miturve (Kavajë), 1 burg të grave dhe një spital burgu (Tiranë).⁵ Ndërkohë masat e emergjencës që u morën për shkak të tërmeteve, që ranë në vend, vunë në vështirësi sektorin e burgjeve.

Reagimi i burgjeve ndaj COVID-19-ës ka treguar që për të qenë të efektshëm, nevojitet përqasje nga e gjithë qeveria dhe nga e gjithë shoqëria, dhe kjo për arsyet si më poshtë:

- Transmetimi i një patogjeni infektiv që prek komunitetin e gjerë, përbën rrezik të transmetimit të infeksionit në mjediset e privimit të lirisë; rreziku i rritjes së shpejtë të transmetimit të sëmundjes brenda burgjeve, ose mjedisëve të tjera të privimit të lirisë, ka

⁵ Informacioni gjendet në faqen e internetit të DPB-së (përdorur për herë të fundit më 17 qershor 2020): <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=836>

gjasa të ketë efekt amplifikues për epideminë, duke rritur shpejt numrin e personave të prekur⁶.

- Përpjekjet për kontrollimin e COVID-19-ës në komunitet ka gjasa të dështojnë nëse në burgje, apo në mjediset e tjera të privimit të lirisë, nuk ndërmerren masa të forta për parandalimin dhe kontrollimin e infeksionit (MPKI), testime të mjaftueshme, trajtim dhe kujdes.
- Përgjegjësia e kujdesit shëndetësor në burgje dhe në mjediset e tjera të privimit të lirisë i takon Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ministria e Drejtësisë/ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë përgjegjësinë të ndjekin protokollet e zhvilluara dhe të paraqitura nga Komiteti Ndërqeveritar përgjegjës për menaxhimin e emergjencës. Bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të shëndetësisë dhe të drejtësisë kanë rëndësi thelbësore për mbrojtjen e shëndetit të personave në burgje, apo në mjedise të tjera të privimit të lirisë, si dhe atë të komunitetit të gjerë.
- Personave në burgje, apo në mjedise të tjera të privimit të lirisë, u është privuar tashmë liria e për këtë arsye, ata mund të reagojnë në mënyrë të ndryshme ndaj masave kufizuese të mëtejshme. Të gjithë veprimet që kufizojnë më tej liritë e personave të privuar nga liria (p.sh. izolimi mjekësor, kufizimi i vizitave, etj.) duhet të:
 - a. Kenë bazë ligjore;
 - b. Kenë fushë-zbatimi dhe kohëzgjatje të kufizuar;
 - c. Jenë të nevojshme dhe përpjesëtimore, si dhe të bazohen në njohuritë më të mira shkencore të gjindshme;
 - d. Mos kenë karakter ndëshkues dhe/ ose të mos krijojnë ide të tillë.

⁶ Koronavirusi i ri i vitit 2019 (2019-nCoV): Përgatitja Strategjike dhe Plani i Reagimit. Gjenevë: Organizata Botërore e Shëndetësisë; 2020 (https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/srp-04022020.pdf?sfvrsn=7ff55ec0_4&download=true)

Metodologjia

Mjediset e burgjeve dhe të paraburgimit kanë gjasa të kthehen në amplifikuese të sëmundjeve infektive si koronavirusi, pasi distancimi social brenda institucioneve të mbyllura është i pamundur dhe lëvizja brenda dhe jashtë këtyre institucioneve është fenomen i zakonshëm. Sidoqoftë, autoritetet shtetërore kanë përgjegjësinë kryesore të sigurojnë ekzistencën e kushteve shëndetësore bazë dhe respektimin e tyre edhe në rrethanat në fjalë.

Vlerësimi bazohet tek analiza e rregulloreve të burgjeve dhe të akteve normative, informacionet e ofruara në raportet me shkrim të DBP-së, takimet, telefonatat me video dhe të dhënat zyrtare që gjenden në rrjet. Për arsye të izolimit në burgje, mbikqyrja e pavarur në burgje dhe në qendra paraburgimi nuk është lejuar si pasojë e një urdhri të Ministrisë së Drejtësisë.

Përbërësit krahasimorë të këtij raporti bazohen te Deklarata e Parimeve të KPT-së, e miratuar rishtazi, në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e Pandemisë së koronavirusit (COVID-19)⁷, udhëzimet e OBSH-së për parandalimin dhe përgatitjen kundër COVID-19-ës⁸, Këshillën e NPT-së për Shtetet Palë dhe Mekanizmat Parandalues Kombëtarë në lidhje me Pandeminë e koronavirusit⁹, Rregullat e Mandelës¹⁰, Rregullat Evropiane të Burgjeve¹¹ në lidhje me të drejtat bazë për trajtimin e të burgosurve dhe te Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹².

Përfundimet e vlerësimit vlejné për hartimin e rekomandimeve me qëllim forcimin e pajtueshmërisë së praktikave ekzistuese me standardet e të drejtave të njeriut në rastet e emergjencave; por gjithashtu, ata kanë për qëllim të përmirësojnë reagimet ndërhyrëse në të

⁷ <https://rm.coe.int/16809cfa4b>

⁸ http://www.euro.who.int/__data/assets/pdf_file/0019/434026/Preparedness-prevention-and-control-of-COVID-19-in-prisons.pdf?ua=1

⁹ <https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/OPCAT/AdviceStatePartiesCoronavirusPandemic2020.pdf>

¹⁰ Për më shumë informacion rreth Rregullave të Nelson Mandelës: <https://www.penalreform.org/issues/prison-conditions/standard-minimum-rules/>

¹¹ https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805d8d25

¹² Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e ndryshuar nga protokollet Nr. 11 dhe 14, 4 Nëntor 1950, ETS 5

ardhmen, duke u përqendruar veçanërisht te masat mbrojtëse përpjesëtimore dhe të efektshme, qasja në informacion dhe te mbikëqyrja e pavarur në burgje.

Analiza e kuadrit ligjor vendas, kuadrit rregullator dhe kushteve në burgje

Vlerësimi bazohet në kombinimin e kërkimeve në bazë të të dhënave dhe analizave ligjore. Kërkimet në bazë të të dhënave bazohet në literaturën përkatëse, legjislacionin vendas dhe aktet normative, instrumentet ligjorë ndërkombëtarë që normojnë trajtimin e personave të privuar nga liria dhe qasjen në të drejtat themelore (d.m.th. shëndetësi, e drejta për informacion, qasja në këshillim ligjor, etj.).

Burimet parësore të vlerësimit janë aktet normative që normojnë gjendjen e emergjencës në burgje; raportet zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe DPB-së. Gjithashtu, u grumbulluan informacione me anë të takimeve, telefonatave me video dhe të dhënave zyrtare të qasshme në faqet e internetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe të DPB-së. Aktet normative, që normojnë gjendjen e emergjencës në burgje, radhiten si më poshtë sipas hierarkisë:

- Ministria e Drejtësisë:
 - Urdhrat Nr. 91 dhe Nr. 92, datë 09.03.2020 "*Për marrjen e masave në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për parandalimin e përhapjes së COVID-19*".
 - Akti Normativ Nr.15, datë 15.04.2020 "*Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit Nr.88 / 2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020"*
 - Urdhri Nr. 95, datë 10.03.2020 i Ministrit të Drejtësisë " Për marrjen e masave për shërbimet në sportele".
 - Urdhri Nr. 90, datë 14.03.2020 i Ministrit të Drejtësisë "*Marrjen e masave për krijimin e infrastrukturës karantinë në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgosurve*".
 - Urdhri Nr. 103, datë 16.03.2020 i Ministrit të Drejtësisë "*Për miratimin e planit të masave organizative dhe administrative për mbarëvajtjen e punës dhe veprimtarisë së*

Ministrisë së Drejtësisë dhe të institucioneve të varësisë së saj, në kuadër të parandalimit të përhapjes së COVID 19”

- Udhëzimi Nr. 6, datë 19.03.2020 i Ministrit të Drejtësisë “*Për marrjen e masave për shërbimin e karantinës me qëllim trajtimin e rasteve të dyshuara më COVID 19, në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale*”.
- Akti Normativ Nr.7, datë 23.03.2020 i Këshillit të Ministrave “*Për lirin e përkohshëm të të burgosurve për një periudhë tre-mujore*”
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve:
 - Urdhri Nr. 2729, datë 09.03.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm “*Për marrjen e masave higjeno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore, akute përfshi dhe COVID-19*”. (Miratim i Protokollit për shërbimin shëndetësor dhe parandalimin e virusit COVID-19)
 - Urdhri Nr. 2846, datë 11.03.2020, i Drejtorit të Përgjithshëm “*Për ngritjen e Task Forcës në DPB dhe IEVP, për zbatimin e masave parandaluese të përhapjes së COVID-19*”
 - Urdhri Nr. 2996, datë 14.03.2020 “*Për vizitat dhe inspektimet në IEVP, për zbatimin e masave parandaluese ndaj COVID-19-ës*”
 - Urdhri Nr. 2729/1, datë 27.03.2020, i Drejtorit të Përgjithshëm “*Për marrjen e masave higjeno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore, akute përfshi dhe COVID-19*”. (Miratim i Protokollit për shërbimin shëndetësor dhe parandalimin e virusit COVID-19)
 - Urdhri Nr. 2729/2 Prot, datë 20.06.2020 “*Mbi zbatimin e masave shtesë të protokollit për parandalimin e përhapjes së virus COVID-19*”

Gjetjet kryesore

- **Pajtueshmëria e reagimit ndaj COVID-it me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut:**

Ndërsa pranohet domosdoshmëria e qartë për ndërmarrjen e veprimeve të forta për të luftuar COVID-19ën, parakushtet për respektimin e plotë të të drejtave themelore, – si ndalimi absolut i torturës dhe trajtimit çnjerëzor apo poshtërues, e drejta për të jetuar dhe për të pasur siguri, e drejta e privatësisë dhe konfidencialitetit, ndihma ligjore, qasja në informacion dhe në mekanizma funksionalë ankimi – vijojnë të jenë thelbësore kur gjykohet mbyllja e plotë e burgjeve si masë mbrojtëse.¹³ Situata të tilla kërkojnë vigjilencë të veçantë për tu siguruar që masat të jenë përpjesëtimore dhe të përbëjnë reagim të nevojshëm ndaj pandemisë që po zhvillohet dhe veçanërisht që ato të mos ndikojnë për keq te ata/ato që gjenden tashmë në situata të cënueshme, sikurse janë të burgosurit.

Sipas standardeve përkatëse të të drejtave të njeriut, siç tregohet në Deklaratën e Parimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtërues (KPT) për COVID-19-ën, është i domosdoshëm përdorimi i alternativave të ndryshme nga privimi i lirisë në situata mbipopullimi dhe mbi të gjitha në situata emergjence.¹⁴ Është i domosdoshëm zvogëlimi i popullatës në burgje për të garantuar zbatimin e efektshëm të rregullave sanitare dhe për të lehtësuar presionin në rritje që përjetohet nga personeli i burgjeve dhe nga vetë sistemi i burgjeve. Mund gjithashtu të përshtatet parimi “mos bëj dëm” përgjatë situatës me COVID-19-ën, e cila karakterizohet nga zhvillime të shpejta, duke zvogëluar numrin e personave në mjediset e privimit të lirisë.

Sistemi shqiptar i burgjeve reagoi duke zbatuar disa akte rregullatore, urdhra, udhëzime dhe plane veprimi të cilat e vendosnin përparësinë tek masat parandaluese dhe izoluese.

Me qëllim zvogëlimin e mbipopullimit në burgje, Ministria e Drejtësisë miratoi një akt normativ në lidhje me lirimin e kushtëzuar tre-mujor për 392 individë të burgosur, të cilët i kanosin rrezik të ulët shoqërisë, që përfshijnë të burgosurit në moshë, të burgosurit jo të dhunshëm dhe me rrezik të ulët dhe ata/ato me sëmundje të rënda mendore.¹⁵

¹³ Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtërues (KPT): Deklarata e parimeve në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së koronavirusit (COVID-19), Mars 2020. Gjendet tek: <https://rm.coe.int/16809cfa4b>

¹⁴ Parimi #5, E njëjta

¹⁵ Akti Normativ Nr. 7/2020 “Për dhënien e lejes së përkohshme për të burgosurit e dënuar, të cilët lejohen të qëndrojnë në shtëpi për një periudhë tre mujore”. Në qershor 2020, DPB-ja e zgjeroi lirimin e kushtëzuar për 278 të burgosur të tjerë

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nxori një urdhër, i cili ktheu dy seksione në pavijone karantine brenda Spitalit të Burgjeve. Kjo u shoqërua nga përgatitja e protokolleve mjekësorë dhe planeve të veprimit për masat parandaluese higjienike në të gjithë sistemin e burgjeve, të cilët u miratuan nga Ministria e Drejtësisë. U krijua një task forcë e posaçme me përgjegjësinë për të ndjekur zbatimin e kuadrit të emergjencës, grumbullimin dhe reagimin ndaj ankesave të të burgosurve, si dhe rishikimin dhe përshtatjen e ndërhyrjeve emergjente në bazë të njoftimeve që vijnë nga komunikimi i brendshëm me administratën e burgjeve.¹⁶ Masat e miratuara përqendrohen kryesisht tek mbrojtja e shëndetit të të privuarve nga liria dhe veçanërisht tek parimet e barazflefshërmisë së kujdesit dhe të qasjes në kujdesin shëndetësor.¹⁷ Mbyllja ishte pozitive, pasi arriti ta mbante të izoluar epideminë në disa burgje. Sipas DPB-së, ka pasur 71 të burgosur të infektuar nga 289 të testuar, dhe 76 anëtarë të personelit të infektuar nga 423 të testuar.¹⁸

Sipas Parimit Nr. 9 të Deklaratës së Parimeve të KPT-së për COVID-19ën, masat mbrojtëse ndaj keqtrajtimit të personave në paraburgim, si qasja tek avokati apo tek njoftimi i paraburgimit, duhet të respektohen plotësisht gjithmonë dhe në çdo rrethanë. Ndërsa Parimi Nr. 10 thekson rëndësinë e mbikëqyrjes së privimit të lirisë që kryhet nga organet e pavarura, si Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) dhe KPT-ja, si masë mbrojtëse thelbësore ndaj keqtrajtimit, duke bërë kujdes maksimal për respektimin e parimit ‘mos bëj dëm’.

Mbyllja në burgjet shqiptare preku këshilltarët ligjorë dhe përfaqësuesit ligjorë për të cilët vizitat në burgje u pezulluan *de facto*. U pezulluan edhe vizitat e familjarëve dhe veprimtaritë e tjera në ajër të hapur. E njëjta gjë vlen për mekanizmat e mbikëqyrjes së privimit të lirisë, duke krijuar kështu vështirësi më përgjigjen e shpejtë ndaj ankesave të të burgosurve. Situata u bë mjaft e vështirë në rrethet e ashtuquajtura “zona të kuqe”, ku institucionet e burgjeve u detyruan të pezullonin çdo transferim të të burgosurve.

¹⁶ Raporti i DPB-së për Komisionin e Sigurisë Kombëtare të Kuvendit të Shqipërisë.

¹⁷ E njëjta, paragrafi 6.

¹⁸ Të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Të dhënat deri në fund të shtatorit 2020.

- **Ndalimi i torturës:**

Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues nuk mund të derogohet as në rrethana përjashtimore ose përgjatë emergjencave që kërcënojnë jetën e kombit.¹⁹ Karakteri i mbyllur dhe i izoluar i burgjeve mund të krijojë mundësinë për veprime abuzive nga ana e administratës së burgjeve ose nga ana e vetë të burgosurve ndaj njëri tjetrit. Personat në paraburgim apo në burgje nuk ndalojnë së qeni qenie njerëzore, pavarësisht krimit për të cilin janë akuzuar apo dënuar.

Parimi i pranuar universalisht për ndalimin absolut të torturës dhe të trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues nuk parashikon asnjë rrethanë në të cilën justifikohen veprime të tilla. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ofron jurisprudencë të zgjeruar, e cila mund të përdoret si referencë në lidhje me përshtatshmërinë e kujdesit,²⁰ shpeshhtësinë dhe cilësinë e kujdesit,²¹ luftën ndaj veprimeve diskriminuese dhe format e tjera të neglizhencës, që mund të përbëjnë trajtim çnjerëzor dhe poshtërues. Sipas Protokollit Fakultativ të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Mizor, Çnjerëzor dhe Poshtërues (OPCAT), parandalimi i torturës dhe i keqtrajtimit me anë të përdorimit të tepruar të masave të izolimit kufizues dhe përdorimi i tepruar i pushtetit të dhunës nënkupton aftësinë për qasje në mbikëqyrje nga ana e organeve të pavarura, duke marrë parasysh faktin se këto mjedise janë nën përgjegjësinë e shtetit. Nuk pranohet asnjë përjashtim nga ky parim universal.²²

Në kontekstin shqiptar, nuk ka raste denoncimi nga ana e të burgosurve të pretendimeve për torturë dhe trajtim çnjerëzor dhe poshtërues. Ndërsa mungesa e mbikëqyrjes së saktë të burgjeve e bën të vështirë arritjen e përfundimeve, janë ngritur shqetësime në lidhje me rritjen e numrit të

¹⁹ Këshilla e Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës dërguar Shteteve Palë dhe Mekanizmave Parandalues

Kombëtarë në lidhje me Pandeminë e koronavirusit (miratuar më 25 mars 2020); [internet]

<https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/OPCAT/AdviceStatePartiesCoronavirusPandemic2020.pdf> (përdorur për herë të fundit më 1 qershor 2020)

20 Amirov v. Rusia, 2014, § 9; Mustafayev v. Azerbajxhan, 2017, § 53 dhe Jasinskis v. Letonia, 2010, § 60; https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Prisoners_rights_ENG.pdf

21 Neni 3 detyron shtetin të mbrojë mirëqenien fizike të personave të privuar nga liria duke, ndër të tjera, i ofruar atyre kujdesin shëndetësor të nevojshëm (Kudła v. Polonia [GC], 2000, § 94; Paladi v. Moldavia [GC], 2009, § 71; Blokhin v. Rusia [GC], 2016, § 136). Kështu, në shumë raste Gjykata ka vendosur se mungesa e kujdesit shëndetësor të përshtatshëm mund të përbëjë trajtim të ndryshëm me atë të parashikuar nga neni 3 (Po aty.; Wenerski v. Polonia, 2009, §§ 56-65); duke nxjerrë në pah dështime të renda me kujdesin shëndetësor të ankuesit (Krivolapov v. Ukraina, 2018, § 76, me referenca të mëtejshme).

22 UNCAT, Neni 2(2) dhe ICCPR-ja, nenet 4 dhe 7.

masave disiplinore, veçanërisht ndaj atyre në paraburgim. Personeli i burgjeve e shpjegon këtë fenomen si pasojë e rritjes së nivelit të pasigurisë nga të burgosur, të cilët në kushte normale nuk do të thyenin rregullat e brendshme të burgjeve. Gjithashtu, janë ngritur shqetësime në lidhje me zbatimin e parimit të përpjesëtueshmërisë.²³

- **Ulja e mbipopullimit në burgje:**

Përdorimi i parimit “mos bëj dëm” bëhet i cenueshëm gjatë zbatimit të vendimeve që lidhen me koronavirusin. Ndërsa nevoja për të parandaluar shkeljet e karantinës së vendosur nga shteti nuk vihet në dyshim, përgjigja duhet jetë kërcënimi me dënime të gjata. Sikurse nënvizohet nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, masat e karantinës mund të kenë pasoja të skajshme për personat që janë duke mbijetuar me vështirësi nga pikëpamja ekonomike: “[masa parandaluese të tilla] mund të çojnë në humbjen e pagesës apo të vendit të punës, me pasoja të mëdha për jetesën dhe jetët e individëve.”²⁴ Nga ana tjetër, kriminalizimi/privimi i lirisë së individëve për shkak të shkeljes së karantinës, me qëllim mbrojtjen e shoqërisë nga përhapja e COVID-19-ës, mund të krijojë një barrë të shtuar për sistemin e burgjeve duke rritur numrin e individëve, që vendosen në karantinë të detyruar për 14 ditë me të filluar gjykimi paraprak. Gjithashtu, në rastet e emergjencës, prezumimi i pafajësisë është parim me rëndësi madhore, i cili duhet të merret parasysh përpara çdo mase të mundshme penale. Në këtë kontekst, privimi i lirisë duhet të jetë masa fundore dhe gjykimet duhet të marrin parasysh kushtet dhe arsyet se përse ai individ i caktuar ka thyer masën parandaluese. Privimi i lirisë së individëve për shkak të shkeljes së karantinës, mund të ketë ndikim negativ te masat për uljen e mbipopullimit në burgje dhe te kushtet e mjediseve të paraburgimit.

Gjatë gjendjes së emergjencës, sistemi shqiptar i burgjeve u përball me rritje të numrit të personave në paraburgim.

Sipas statistikave zyrtare të DPB-së, numri i personave në paraburgim krahasuar me numrin e të burgosurve dhe numrin e mjediseve shkon sa 52- 58% e popullsisë në burgje:

23 Parimi #4, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor dhe Poshtërues (KPT): Deklarata e parimeve në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së koronavirusit (COVID-19), mars 2020. Gjendet në: <https://rm.coe.int/16809cfa4b>

²⁴ ‘Koronavirusi: Të drejtat e njeriut duhet të jenë qëllimi dhe thelbi i reagimeve, thotë Bachelet’, 6 mars 2020, gjendet tek <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25668&LangID=E>.

Muaji	Paraburgim	Burgim
Janar 2020	2286	2777
Shkurt 2020	2326	2760
Mars 2020	2192	2644
Prill 2020	2979	2622
Maj 2020	1929	2545
Qershor 2020	2002	2502
Korrik 2020	2060	2448
Gusht 2020	2181	2452
Shtator 2020	2347	2402

Shënim: Nuk është llogaritur numri i personave nën trajtim të detyrueshëm.

- **Kushtet materiale të burgjeve:**

Parimi #1 i Deklaratës së parimeve të KPT-së në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së koronavirusit (COVID-19) thekson rëndësinë e të gjitha veprimeve të mundshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së të gjithë personave të privuar nga liria. Veprime të tilla japin gjithashtu kontribut për ruajtjen e shëndetit dhe të sigurisë së personelit të burgjeve.

Në kontekstin e Shqipërisë, një gjë e tillë është bërë me anë të Urdhrave Nr. 91 dhe Nr. 92, datë 09.03.2020 " *Për marrjen e masave në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për parandalimin e përhapjes së COVID-19*" dhe Urdhrit Nr. 103, datë 16.03.2020 i Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e planit të masave organizative dhe administrative për mbarëvajtjen e punës dhe veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe të institucioneve të varësisë së saj, në kuadër të parandalimit të përhapjes së COVID 19". Këto veprime kërkuar prej burgjeve të mendonin kuadrin rregullator me udhëzime dhe protokolle për të trajtuar emergjencën, menaxhuar karantinën brenda spitaleve të burgut, si dhe për të caktuar përparësi për kategoritë e veçanta të të burgosurve që mund të lirohen me kusht.

Situata e epidemisë kërkoi transferime buxhetore dhe disa ndryshime, pasi kishte nevojë për masa sanitare. Mundësia e përdorimit të ujit (të nxehtë) në burgje është e kufizuar për arsye të mungesës së infrastrukturës për të pasur rubineta uji në secilën qeli. Ky shqetësim vlen në mënyrë të njëjtë për mjediset ekzistuese dhe ato të reja. U raportua se kishte dezinfektues duarsh dhe dezinfektues të llojeve të tjera në shumicën e burgjeve. Kjo ishte përgjegjësi e autoriteteve të burgjeve, për arsye të përmbajtjes së alkoolit dhe elementëve të tjerë të sigurisë së brendshme.

Distancimi fizik në burgjet shqiptare mbetet i vështirë në shumicën e burgjeve/ mjediseve të paraburgimit në Shqipëri, si p.sh. në Fushë-Krujë, Fier, Shën Koll, “Jordan Misja”, “Ali Demi”, Peqin, Rrogozhinë, etj., veçanërisht në rastet e diktimit të të burgosurve/ personelit të infektuar. Mungesa e hapësirës për person është shqetësim që ngrihet vazhdimisht nga vizitat e KPT-së në Shqipëri. Po të faktorizojmë edhe kriteret e OBSH-së për rregullin e distancimit social/ fizik prej dy metrash, situata kthehet në shkelje të të drejtave të njeriut.

Autoritetet e burgjeve përgatitën Urdhrin Nr.90, datë 14.03.2020 i Ministrisë të Drejtësisë “Marrjen e masave për krijimin e infrastrukturës karantinë në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgosurve” dhe Udhëzimin Nr.6, datë 19.03.2020 " Për masat për shërbimin e karantinës së rasteve me COVID-19 brenda sistemit të burgjeve". Njëra pas tjetrës, këto akte normative udhëhoqën përgatitjen e protokollëve të ndërhyrjes në lidhje me regjimin e karantinës brenda mjediseve të burgjeve.

Me urdhër të DPB-së, Spitalit të burgjeve iu dha statusi i mjedisit të karantinës për COVID-19-ën. Përveç këtij statusi, ai vepron si mjedis për çdo rast tjetër urgjence, si dhe për pritjen e të burgosurve nën trajtim mjekësor të detyrueshëm. Ky status i veçantë rrit ngarkesën e punës së personelit mjekësor dhe të atij të burgjeve.

- **Qasja te këshillimi liqjor:**

Sipas Parimit #9 të Deklaratës së parimeve të KPT-së në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së koronavirusit (COVID-19), masat mbrojtëse themelore ndaj keqtrajtimin të personave në paraburgim (qasja tek avokati, te mjeku, njoftimi i paraburgimit) duhet të respektohen plotësisht gjithmonë dhe në çdo rrethanë.

Vendimi i KLGJ-së për pezullimin e të gjitha veprimtarive dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit krijoi vështirësi për qasjen te ndihma ligjore. Ky vendim, i cili u mor menjëherë pasi qeveria shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore, çoi në rritje të numrit të personave në paraburgim dhe në shtim të shqetësimeve rreth menaxhimit të epidemisë në sistemin e burgjeve.²⁵

Mbyllja në burgje preku punën e këshilltarëve ligjorë, vizitat e të cilëve në burgje u pezulluan *de facto*. U pezulluan edhe vizitat e familjarëve dhe veprimtaritë e tjera në ajër të hapur. E njëjta gjë vlen për mekanizmat e mbikëqyrjes së privimit të lirisë, duke krijuar kështu vështirësi në përgjigjen e shpejtë ndaj ankesave të të burgosurve. Në këto kushte, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve e rishikoi vendimin për ndalimin e përdorimit të internetit dhe telekomunikimit në regjimin e burgjeve, duke lejuar përdorimin e telefonatave me video dhe organizimin e takimeve me anë të internetit si zëvendësues të takimeve fizike.

Privimi i lirisë së individëve përgjatë gjendjes së emergjencës në kushtet kur nuk ka mbikëqyrje të pavarur të burgjeve mund të shihet si shkelje e Parimit #10 për mbikëqyrjen e pavarur të Deklaratës së parimeve të KPT-së në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së koronavirusit (COVID-19).

Kërkesa e KPT-së për masa paraprake (si kërkesa për personat me simptoma për mbajtjen e maskave mbrojtëse, ose mundësimin e ndarjeve me xham) mund të jetë e përshtatshme në disa rrethana.²⁶

- **Qasja në informacion:**

Pavarësisht niveleve të emergjencës, çdo ndryshim i regjimit të burgut që prek të gjithë institucionin (të burgosurit dhe personelin e burgjeve) duhet të komunikohet në mënyrë të shpejtë, me informacione të qarta për kufizimet dhe për periudhat kohore të shqyrtimit, apo për

25 Këshilli i Lartë Gjyqësor, Vendimi Nr.127, datë 10.03.2020 “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”. E qasshme në: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/03/127.-vendim-pezullim-veprimtarie-ne-gjykata.pdf>

26 Parimi #9, Deklarata e parimeve të KPT-së në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së koronavirusit (COVID-19)

heqjen e këtyre politikave dhe mundësitë për ankesa.²⁷ Në rastin e Shqipërisë, nuk ka afate të qarta për zbatimin e masave kufizuese dhe të mbylljes në burgje. Ky informacion nuk gjendet në asnjë prej akteve normative të përgatitur për menaxhimin e epidemisë së COVID-19-ës.²⁸

Procesi i lirimit tre-mujor në shtëpi për 392 individë të burgosur, të cilët i kanosin rrezik të ulët shoqërisë, që përfshijnë të burgosurit në moshë, të burgosurit jo të dhunshëm dhe me rrezik të ulët dhe ata me sëmundje të rënda mendore, ishte mundësi e mirë për të menaxhuar nivelin e mbipopullimit, si dhe mundësi për këta të burgosur të ripërtërinin marrëdhëniet me familjet e tyre. Njëzet e tre prej 392 lejeve të veçanta u revokuan si pasojë e shkeljes së lejes së veçantë. Deri në fund të muajit shtator 2020 të dënuarit e trajtuar me leje të veçantë janë kthyer në burgje si rezultat i përfundimit të tremujorit të dytë të zgjatjes së lejes. Pas përfundimit të lejes së veçantë, vetëm dy të dënuar nuk janë kthyer në institucion, janë ende në kërkim.

Duke parë vazhdimësinë e pandemisë, iniciativa të tilla janë të vlefshme. Nëse do të ketë iniciativa të tilla, DPB-ja do të përballet përsëri me kthimin e kësaj kategorie të burgosurish. Praktikisht, kjo do të thotë se do të ketë nevojë për një plan shpërndarjeje, karantinimi dhe kushte qëndrimi të posaçme, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare. Kthimi nga lirimi me kusht duhet të nënkuptojë kushte qëndrimi të posaçme dhe kontroll mjekësor të përshtatshëm nga autoritetet e burgut dhe jo vetëm izolim.

Në rastet e ndarjes për arsye mjekësore, të burgosurit duhet të njoftohen në mënyrë të përshtatshme. Në rast izolimi, apo karantinimi, të një të dënuari të infektuar apo të dyshuar se mund të jetë i/e infektuar me virusin SARS-CoV-2, personit duhet t'i ofrohet kontakt i qenësishëm njerëzor çdo ditë.²⁹ Nevoja për vazhdimin e programeve të rehabilitimit, trajtimit psikologjik dhe terapevutik vazhdon të ekzistojë për të gjithë personat e privuar nga liria. Edhe pse

27 Parimi #4, Deklarata e parimeve të KPT-së në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së koronavirusit (COVID-19)

28 Ky informacion i referohet Urdhrit Nr. 2729, datë 09.03.2020 "Për marrjen e masave higjieno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore, akute përfshi dhe COVID-19". (Miratim i Protokollit për shërbimin shëndetësor dhe parandalimin e virusit COVID-19); Urdhrit Nr. 2846, datë 11.03.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm "Për ngritjen e Task Forcës në DPB dhe IEVP, për zbatimin e masave parandaluese të përhapjes së COVID-19" dhe Urdhrit Nr. 2996, datë 14.03.2020 "Për vizitat dhe inspektimet në IEVP, për zbatimin e masave parandaluese ndaj COVID-19-ës".

29 Parimi #8, Deklarata e parimeve të KPT-së në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së koronavirusit (COVID-19).

personeli që trajton psikologjinë dhe edukimin ka qenë i pranishëm dhe ka ofruar mbështetje dhe këshillim psikologjik, presioni i masave të zgjatura të izolimit ka pasur ndikim te të burgosurit.

Edhe informimi dhe masat mbrojtëse për pjesëtarët e familjes së personelit të burgjeve janë shumë të rëndësishme. Deri tani, nuk ka akte normative apo udhëzime që të trajtojnë nevojën e shtuar për mbrojtje të pjesëtarëve të familjes të personelit të burgjeve dhe të të burgosurve të liruar me kusht. DPB-ja duhet të shqyrtojë trajtimin e të drejtave për masa mbrojtëse shtesë të pjesëtarëve të familjes së personelit të burgjeve, duke ndryshuar Urdhrin Nr. 103, ose nëpërmjet një akti normativ të posaçëm që parashtron protokollet e kujdesit dhe kontrollet shtesë.

- **Burimet njerëzore të burgjeve dhe emergjencat:**

Në secilin mjedis të burgjeve, personelit i kërkohet të ruajë sigurinë dhe të kujdeset për personat që ata mbikëqyrin. Në rast të mbylljes në burg, ose karantinimit në një mjedis të caktuar, personelit të burgjeve i kërkohet gjithashtu të jetë i izoluar. Personeli i burgjeve duhet të ketë në dispozicion leje të paguara për arsye shëndetësore me qëllim shmangien e situatave ku ata të punojnë edhe po nuk qenë mirë për arsye të nevojave financiare. Urdhri Nr. 103, datë 16.03.2020 i Ministrisë së Drejtësisë “Për miratimin e planit të masave organizative dhe administrative për mbarëvajtjen e punës dhe veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe të institucioneve të varësisë së saj, në kuadër të parandalimit të përhapjes së COVID 19” përmbante dispozita të ngjashme për leje të paguar për arsye shëndetësore. Emergjenca e shkaktuar prej COVID-19-ës ka treguar nevojën për personel mjekësor dhe infermierie të përhershëm dhe të mirë-trajnuar për të reaguar në rast emergjence dhe për t’u ofruar mbështetje të përshtatshme të burgosurve.

Protokollet e miratuara iu shpërndanë të gjithë institucioneve dhe kërkonin ndërhyrje nga një ekip shumë – disiplinor, që dukej të ishte i patrajnuar për të kuptuar dhe zbatuar plotësisht masat në fjalë.

Nevoja e vazhdueshme për trajnim të përshtatur dhe profesional në lidhje me zbatimin rigoroz të masave mbrojtëse dhe parandaluese duhet të përbëjë përparësi. Kohët e fundit kanë nisur disa trajnime në internet për programet e rehabilitimit, të cilat ofrohen nga organizatat joqeveritare. Në rast se kërcënimi do të vijojë të ekzistojë në sistemin shqiptar të burgjeve, informacionet dhe

njohuritë profesionale për infeksionet, sëmundjet ngjitëse dhe urgjencat mjekësore duhet të jenë të shpeshta dhe sipas disiplinave të ndryshme profesionale.

Rekomandimet dhe mësimet e marra

- Sfida e ndërlikuar e luftës ndaj përhapjes së koronavirusit në mjediset e privimit të lirisë ka kërkuar reagim të menjëhershëm nga sistemi i burgjeve në Shqipëri, duke miratuar akte normative dhe udhëzime të shumta si pjesë e një plani parandalues gjithëpërfshirës. Ky kuadër ligjor i zgjeruar kërkon burime njerëzore dhe financiare të përshtatshme, furnizime mjekësore dhe trajnim të personelit që trajton vazhdimisht burimet qeveritare dhe joqeveritare. Efektshmëria e masave bazohet te qasja në informacione të shpejta dhe të përditësuara që duhet t'u ofrohen secilit person të burgosur, këshilluesit ligjor, apo përfaqësuesëve të familjes.
- Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues nuk mund të derogohet as në rrethana përjashtimore, ose përgjatë emergjencave që kërcënojnë jetën e kombit.³⁰ Karakteri i mbyllur dhe i izoluar i burgjeve mund të krijojë mundësinë për veprime abuzuese nga ana e administratës së burgjeve, ose nga ana e vetë të burgosurve ndaj njëri tjetrit.
- Procesi i lirimit në shtëpi për të personat e burgosur, të cilët i kanosin rrezik të ulët shoqërisë, që përfshijnë të burgosurit në moshë, të burgosurit jo të dhunshëm dhe me rrezik të ulët dhe ata me sëmundje të rënda mendore, ishte mundësi e mirë për të menaxhuar nivelin e mbipopullimit, si dhe mundësi për këta të burgosur të ripërtërinin marrëdhëniet me familjet e tyre. Praktikisht, kjo do të thotë se do të ketë nevojë për plan shpërndarjeje, karantinë dhe kushte qëndrimi të sakta në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare. Kthimi nga lirimi me kusht duhet të nënkuptojë kushte qëndrimi të sakta dhe kontroll mjekësor të përshtatshëm nga autoritetet e burgut dhe jo thjeshtë izolim.
- Privimi i lirisë së individëve përgjatë gjendjes së emergjencës, në kushtet kur nuk ka mbikëqyrje të pavarur të burgjeve, mund të shihet si shkelje e Parimit #10 për mbikëqyrjen e pavarur të Deklaratës së parimeve të KPT-së në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së koronavirusit (COVID-19). Duhet garantuar qasja tek organet mbikqyrëse në të gjitha mjediset e privimit të lirisë,

³⁰ Këshilla e Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës dërguar Shteteve Palë dhe Mekanizmave Parandalues Kombëtarë në lidhje me Pandeminë e koronavirusit (miratuar më 25 mars 2020); [internet] <https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/OPCAT/AdviceStatePartiesCoronavirusPandemic2020.pdf> (përdorur për herë të fundit më 1 qershor 2020)

përfshirë vendet ku personat mbahen në karantinë, duke përdorur parimin “mos bëj dëm”, veçanërisht në rastin e personave të moshuar dhe personave me sëmundje mjekësore ekzistuese”.

- Ndarja për arsye mjekësore duhet njoftuar në mënyrë të përshtatshme. Në rast izolimi, apo vendosjeje në karantinë të një të dënuari të infektuar, ose të dyshuar se mund të jetë i/e infektuar me virusin SARS-CoV-2, personit duhet t’i ofrohet kontakt i qenësishëm njerëzor çdo ditë.
- Edhe pse personeli që trajton psikologjinë dhe edukimin ka qenë i pranishëm dhe ka ofruar mbështetje dhe këshillim psikologjik, presioni i masave të zgjatura të izolimit ka pasur ndikim te të burgosurit.

Programet e rehabilitimit, trajtimi psikologjik dhe terapitë në kontekstin e burgut, luajnë rol thelbësor për mirëqenien e të burgosurve. Ata vijnë të jenë të rëndësishëm për të pasur mjedis burgu të sigurt. Sipas Ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve,” rehabilitimi qëndron në bërthamë të burgimit dhe, si i tillë, riaktivizimi i këtyre programeve duke trajtuar nevojat individuale mund të zvogëlojë, ndër të tjera, dhunën ndërmjet të burgosurve dhe shkeljet e tjera të regjimit të burgut.

- Duke marrë parasysh orët e gjata të punës dhe kushtet e vështira, puna e personelit të burgjeve dhe mirëqenia personale mbeten përparësi. Me kërcënimin aktual dhe me kërcënimet në të ardhmen prej valëve të mundshme epidemike, vazhdon të ekzistojë nevoja për trajnime profesionale dhe të përshtatura që i kushtohen jo vetëm personelit mjekësor, psikologjik dhe psikiatrik, por edhe personelit të sigurisë dhe drejtuesve të lartë. Trajnime të tilla mund të trajtojnë menaxhimin e burimeve njerëzore, transferimet financiare, caktimin e përparësive dhe reagimet në rast emergjencash.

Bibliografia

Botimet:

Këshilla e Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës dërguar Shteteve Palë dhe Mekanizmave Parandalues Kombëtarë në lidhje me Pandeminë e koronavirusit (miratuar më 25 mars 2020)

Raporti i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve PB-së për Komisionin e Sigurisë Kombëtare të Kuvendit të Shqipërisë

Ruajtja e shërbimeve shëndetësore bazë, OBSH 2020

Koronavirusi i ri i vitit 2019 (2019-nCoV): Përgatitja Strategjike dhe Plani i Reagimit; Organizata Botërore e Shëndetësisë

Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Reforma Penale Ndërkombëtare, Dokument Udhëzues për Rregullat e Nelson Mandelës, OKB

APT/ODIHR Udhëzim për Mbikëqyrjen e Mjedisve të Privimit të Lirisë përgjatë Pandemisë COVID-19, 2020

Lista e kontrollit në burgje për përgatitjen dhe reagimin në mjediset e privimit të lirisë

Deklarata e Komisionerit të KiE-së për të Drejtat e Njeriut, pandemia “COVID-19: nevojiten hapa urgjentë për të mbrojtur të drejtat e të burgosurve në Evropë”,

Deklarata e parimeve në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së koronavirusit (COVID-19); Botuar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar (KPT), mars 2020

Praktika e UNODC-së për “gjykimet në distancë” për të burgosurit

Institucionet:

- Niveli kombëtar:

Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni Parlamentar për Sigurinë Kombëtare

Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Avokati i Popullit, Mekanizmi Parandalues Kombëtar

- Nivelet rajonale dhe ndërkombëtare:

Këshilli i Evropës, Komisioni për Parandalimin e Torturës

Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës, Kombet e Bashkuara

Reforma Penale Ndërkombëtare

Faqet e internetit:

http://www.euro.who.int/data/assets/pdf_file/0019/434026/Preparedness-prevention-and-control-of-COVID-19-in-prisons.pdf

<https://icpa.org/wp-content/uploads/2020/04/Expert-Network-Newsletter-Special-Issue-5-1.pdf>

https://www.apt.ch/en/news_on_prevention/monitoring-deprivation-of-liberty-in-times-of-covid-19-insights-from-webinar-series/

<https://www.penalreform.org/resource/coronavirus-healthcare-and-human-rights-of-people-in/>

<https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/covid-19-pandemic-urgent-steps-are-needed-to-protect-the-rights-of-prisoners-in-europe>

<https://rm.coe.int/16809cfa4b>

<https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/OPCAT/AdviceStatePartiesCoronavirusPandemic2020.pdf>

https://peacekeeping.un.org/sites/default/files/prison_checklist_04_02_20_covid-19_preparedness_and_response_in_places_of_detention_unitar.pdf



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri